DEKLARATA
MBI PRIVATINË PËR KRYERJEN E VIDEO MBIKQYRJES

Kjo Deklaratë e Privatësisë shpjegon llojin e të dhënave personale që Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup (në tekstin e mëtejmë: Kontrolluesi) mbledh nga ju kur vizitoni hapsirat zyrtare/afariste dhe se si kontrolluesi i përdor këto të dhëna.

1. Pse mbledhim (përpunojmë) të dhëna personale?

Kontrolluesi mbledh të dhëna personale përmes sistemit të video mbikëqyrjes për arsyet (qëllimet) e mëposhtme:

- të kontrollojë hyrjen në objekt (ndërtesë, hyrje, hapsira...) dhe të garantojë sigurinë e objektit, sigurinë e punonjësve dhe vizitorëve të Kontrollorit, si dhe pronën dhe informacionin që ndodhen ose mbahen në objekt;
- për të parandaluar, penguar dhe, nëse është e nevojshme, për të hetuar qasjen e paautorizuar fizike, duke përfshirë qasjen e paautorizuar në mjediset e sigurisë dhe të mbrojtura, infrastrukturën e TI ose informacionin operativ; dhe
- për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar vjedhjen e pajisjeve ose qasjen në pronësi të Kontrollorit, vizitorëve ose punonjësve, ose kërcënime ndaj sigurisë së personelit që punon në ato hapsira (për shembull: zjarri, sulmi fizik).

Sistemi i video mbikëqyrjes nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, si për shembull për të monitoruar punën e punonjësve apo prezencën e tyre. Videokamerat vendosen në mënyrë që të mos mbulojnë hapësirën publike përreth. Kamerat synojnë të japin një pasqyrë të përgjithshme të asaj që po ndodh në vende të caktuara, por jo të njohin fytyrat.

Sistemi i vëzhgimit me video nuk përdoret gjithashtu si mjet hetimor ose për të marrë prova gjatë hetimeve të brendshme ose procedurave disiplinore, përveç rasteve kur bëhet fjalë për një incident sigurie për të cilin video mbikëqyrja është krijuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale. (Në rrethana të jashtëzakonshme, të dhënat mund t'u transferohen organeve hetimore brenda kuadrit të një hetimi formal disiplinor ose penal).

Kamerat e vëzhgimit janë instaluar, pozicionuar dhe fokusuar në mënyrë që të regjistrohen vetëm personat që hyjnë në zyrat/hapsitat e bankës.

Sistemi i video mbikëqyrjes mbulon siperfaqen e: në hyrjet dhe daljet e brendshme të ndërtesës dhe në korridoret e objektit.

2. Çfarë të dhënash mbledh kontrolluesi?

Kontrolluesi mbledh vetëm imazhet e kapura në kamera, nuk kryhet asnjë audio regjistrim.

3. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave?

Kontrolluesi është subjekt që kryen përpunimin e të dhënave personale dhe që përcakton qëllimet e përpunimit, vetëm në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, drejtori i sektorit për punë juridike dhe të përgjithshme është personi kontaktues dhe përgjegjës për vëzhgimin me video.

4. Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të mbikëqyrjes video?

Kontrolluesi përdor mjetet e video mbikëqyrjes për:
- mbrojtjen jetësore ose e shëndetin e njerëzve;
- mbrojtja e pronës;
- mbrojtja jetësore dhe e shëndetit të punësuarve për shkak të natyrës së punës;
- sigurimin e kontrollit mbi hyrjen dhe daljen nga hapsirat zyrtare ose afariste.

Prandaj, përpunimi është i ligjshëm sipas nenit 90 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
Gjithashtu, në hyrje të Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, ka një njoftim të dukshëm dhe të skaduar për video-mbikëqyrjen që u mundëson subjekteve të të dhënave personale të njihen me performancën e video-mbikëqyrjes, si dhe emri i kontrollorit i cili kryen vëzhgimin me video dhe mënyra se si mund të merret informacioni se ku dhe për sa kohë ruhen pamjet nga sistemi i vëzhgimit me video.

5. Kush mund t'i shohë të dhënat e mia personale?

Video regjistrimet mund të kenë qasje vetëm nga persona të autorizuar për video mbikëqyrje (për shembull: anëtarët e stafit të sigurisë së Kontrollorit ose Agjencia Private e Sigurisë së të punësuarve). Qasja në pajisjen dixhitale ose në diskun në të cilin ruhen video regjistrimet është e kufizuar, e mbrojtur nga aplikimi i masave teknike të sigurisë së të dhënave (fjalëkalimi, regjistrimi për çdo ngjarje apo veprim nga punonjësit, pra personat e autorizuar). Të dhënat, përkatësisht video incizimet nuk mund të qasen pa autorizim nga Bordi Drejtues i Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut SHA Shkup.

6. Si të kontrolloni të dhënat tuaja?

Kërkesa mund të dërgohet në e-mail: info@mbdp.com.mk, ose në adresën: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, rr. “Dimitrie Çupovski” nr. 26, Shkup.

7. A mund të kem qasje tek të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të keni qasje tek të dhënat tuaja në çdo kohë dhe pa pagesë, duke dërguar kërkesë në e-mail: info@mbdp.com.mk, ose në adresën: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, rr. “Dimitrie Çupovski” nr. 26, Shkup.

8. A mund t'i ndryshoj të dhënat e mia?

Nuk lejohet modifikimi i pamjeve në videombikëqyrjet.

9. A mund të kërkoj kufizimin e përpunimit të të dhënave të mia?

Ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në çdo kohë duke dërguar kërkesë në e-mail info@mbdp.com.mk, ose në adresën: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, rr. “Dimitrie Çupovski” nr. 26, Shkup, kur kontestoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, ose kur kontrolluesi nuk ka më nevojë për të dhënat për të kryer detyrat e tij.

Ju gjithashtu mund të bllokoni përpunimin dhe kur puna është e paligjshme dhe ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave. Megjithatë, bllokimi nuk është i mundur në çdo rast të një hetimi zyrtar.

10. A mund t'i fshij të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë t'i fshini të dhënat tuaja në çdo kohë duke dërguar kërkesë në e-mail: info@mbdp.com.mk, ose në adresën: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 26, Shkup, kur përpunimi është i kundërligjshëm.

11. A ndahen të dhënat e mia personale me njerëz të tjerë?

Të dhënat tuaja ruhen në kontrollues, përveç nëse i kërkoni kontrolluesit ose jepni pëlqimin tuaj për t'i ndarë ato. Në rast të ndarjes së të dhënave tuaja me palët e treta, do të njoftoheni se kujt i janë zbuluar ato, për çfarë qëllimi dhe mbi çfarë baze ligjore.

12. A kam të drejtë të kundërshtoj?

Po, ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin në çdo kohë duke dërguar kërkesë në e-mail: info@mbdp.com.mk, ose në adresën: Banka për zhvillim e Maqedonisë së Veriut SHA Shkup, rr. "Dimitrie Çupovski" nr. 26, Shkup, kur keni arsye legjitime në lidhje me situatën tuaj specifike. Kontrollori do të veprojë sipas kërkesës tuaj brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

13. Çfarë mund të bëj në rast problemi?

a) Hapi i parë është të njoftoni kontrolluesin duke dërguar një e-mail në: info@mbdp.com.mk dhe kërkojini atij të marrë masa.

b) Hapi i dytë, nëse nuk merrni përgjigje nga ne ose nëse nuk jeni të kënaqur me të, kontaktoni zyrtarin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale në dpo@mbdp.com.mk.

c) Në çdo kohë, ju mund të parashtroni kërkesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale www.azlp.mk, e cila do të veprojë sipas kërkesës tuaj dhe do të marrë masat e nevojshme.

14. Kur do të fillojë përpunimi i të dhënave të mia personale përmes sistemit të mbikëqyrjes video?

Përpunimi fillon në momentin që ju vizitoni hapsirat e Kontrollorit.

15. Siguria e të dhënave personale

Kontrolluesi është i përkushtuar të mbrojë të dhënat tuaja personale. Prandaj, ai përdor teknologjitë dhe procedurat e sigurisë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale kryesisht nga qasja, përdorimi ose zbulimi i paautorizuar. Ne i ruajmë të dhënat tuaja në sisteme kompjuterike me qasje të kufizuar dhe në një mjedis të kontrolluar.

16. Sa kohë i ruajmë të dhënat tuaja?

Kontrolluesi do t'i ruajë të dhënat tuaja personale për 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas vizitës suaj në hapsirat tona, pas së cilës të gjitha videot e regjistruara fshihen automatikisht.